

## Rruga Orikum- Tragjas, gati për sezonin turistik

---

*Ndërtimi i rrugës, u financua nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkia 06 shkurt 2011 23:07*



Ndërtimi i rrugës që lidh qytezën e Orikumit me fshatin Tragjas, 20 km në jug të Vlorës, vlerësohet si një mundësi më shumë për zhvillimin e turizmit në këtë zonë me resurse të rëndësishme.

Ndërtimi i kësaj rruge me gjatësi prej 5 km, aq sa është edhe largësia nga bregu i detit, u realizua me një fond prej rreth 40 milionë lekësh, të financuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia e Orikumit. Në realizimin e këtij projekti, sipas kryetarit të Bashkisë, Kanan Braho, janë parashikuar standardet e një investimi cilësor dhe në përshtatje për zonat e zhvillimit të turizmit.

Fshati Tragjas dhe në tërësi bregdeti i Orikumit, spikasin jo vetëm për bukuritë natyrore të një zone bregdetare, por edhe për vlera arkeologjike e kulturore, në funksion të turizmit.

Në këtë pjesë të bregdetit, ka nisur të plotësohet struktura turistike me hotele e lokale të shumta, ndërkohë që ndërtimi i rrugës, deri para pak muajsh e amortizuar tërësisht, do të përmirësojë komoditetin e lëvizjes së automjeteve.

Ky projekt, është pjesë e investimeve të realizuara në bashkinë e Orikumit, në vitet e fundit.

Pak javë më parë, nisi projekti i ndërtimit të sistemit të ujësjellës kanalizimeve të kësaj bashkie, që financohet nga Banka Islamike dhe qeveria shqiptare, me një vlerë prej 16.5 milionë USD.

Ky projekt, që është investimi më i madh, që është bërë ndonjëherë në të gjithë bregdetin që administron kjo bashki, zgjidh plotësisht furnizimin me ujë të pijshëm dhe përpunimin e ujrave të zeza në qytetin e Orikumit dhe fshatrat që administron kjo njësi e qeverisjes vendore.

Sistemi aktual i ujësjellësit në bashkinë e Orikumit, garanton furnizimin ditor të banorëve vetëm për rreth katër orë, ndërkohë që kanalizimet e ujrave të zeza në pjesën më të madhe mungojnë ose janë të amortizuara.

Përfundimi i projektit brenda një periudhe 3-4 vjeçare, do të mbrojë hapësirën detare nga ndotja që shkaktohet nga derdhja e ujrave të zeza, të cilat përmes impiantit të përpunimit do të shndërrohen në ujra të zakonshme.